

## KALLZIM PENAL

- DREJTUAR :** Prokurorisë së Posaçme pjese e Strukturës se Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar, me inicialet SPAK.
- PER DIJENI:** Arben Kraja drejtues i SPAK.
- KUNDER:** Erion Veliaj me cilesine si Kryetar i Bashkisë Tiranë.
- OBJEKTI:** Fillimin e ndjekjes penale ndaj shtetasit Erion Veliaj me funksion Kryetar i Bashkisë Tiranë për veprën penale “Shpërdorim i detyrës”, të parashikuar nga neni 248, të Kodit Penal.
- BAZA LIGJORE:** Ligji Nr.95/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” Ligji Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligji Nr.9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, Ligjit Nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, neni 248 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, nenet 1, 280 dhe 283 të Kodit të Procedurës Penale dhe neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

---

*ë nderuar Prokurorë të Prokurorisë së Posaçme,  
z. Kraja,*

duke shprehur besimin dhe konsideratën tonë në strukturën e SPAK, Ju bëjmë  
e dije se, ne kallëzuesit jemi pjesë e Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit (Teatrit  
ombëtar dhe Eksperimental), i cili është një organizim artistësh dhe qytetarësh  
cilët që prej shkurtit të vitit 2018 ushtrojnë të drejtën e protestës duke  
ndërshtuar projektin e Teatrit të Ri Kombëtar të denoncuar në media dhe me  
lëzime nga ana jonë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

muaj prill 2019 jemi vënë në dijeni se në zbatim të Ligjit Nr.37/2018 (Ligji  
cial), “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin  
lidhjen e kontratës me objekt: “Projektimi dhe realizimi i projektit urban  
godinës së re të Teatrit Kombëtar””, me propozimin e ministrit të Kulturës



dhe e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave ka vendosur nxjerrjen e VKM-se Nr.352 datë 04.04.2019 me qëllim:

a) krijimin e komisionit për realizimin e procedurave të vlerësimit dhe të negocimit të kontratës me objekt realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar, si dhe hartimin e kontratës me palën private të përzgjedhur;

b) përcaktimin e kriterëve kualifikuese e vlerësuese dhe dokumentacionin e kërkuar për përzgjedhjen e palës private që do të marrë përsipër realizimin e projektit të zhvillimit të zonës dhe të godinës së re të Teatrit Kombëtar.

Ju kujtojmë se Ligji Special Nr.37/2018 është ankimuar nga Presidenti i Republikës në Gjykatën Kushtetuese në datë 24.07.2019.

Konkursi do të zhvillohej sipas kriterëve kualifikuese të përcaktuara në Kreun IV. dhe kriteret vlerësuese të përcaktuara në Kreun V sipas pikës 1./a, b dhe c.

Në Kreun VII pika 1. E kësaj VKM-je, Kryetari i Bashkisë Tiranë ngarkohet me cilësinë e autoritetit kontraktor që të krijojë komisionin për ndjekjen e procedurave për përzgjedhjen me procedurë të veçantë të konsulentit për vlerësimin, përzgjedhjen, negocimin dhe lidhjen e kontratës me palën private, Komisioni I cili sipas pikës 2. Duhet të përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë, specialistë të fushave përkatëse të autoritetit kontraktor (juristë, ekonomistë dhe inxhinierë).

Referuar sa më sipër, më datë 18.10.2019 (data sipas deftesës së pranimit të objekteve postare), në zbatim të Ligjit Nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", kemi paraqitur një kerkese pranë Bashkisë Tiranë, e cila është protokolluar nga kjo e fundit me Nr.44397 Prot datë 18.10.2019.

Po kështu këtë kërkesë ja kemi vënë në dijeni dhe të gjithë anëtarëve të Komisionit të vlerësimit dhe negocimit i cili sipas pikës 1. të Kreut II kryesohet nga zëvendëskryetari i Bashkisë së Tiranës dhe përbëhet nga (gjashtë) anëtarë, përfaqësues të institucioneve të mëposhtme:

- a) Ministria e Kulturës;
- b) Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- c) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- ç) Ministria e Drejtësisë;



d) Avokatura e Shtetit;

dh) *Trupa teatrore.*

Nga anëtarët e Komisionit të sipërcituar, më datë 23.10.2019 nga Ministria e Drejtësisë na përcillet shkresa Nr.7115/1 Prot ku na sqarohet (shkresa bashkëngjitur) se: “Bashkia Tiranë si institucion kryesues i mbledhjes të komisionit mund t’ju përcjellë të gjithë informacionin e detajuar për sa kërkohet”.

Po kështu, na rezulton se më datë 25.09.2019 gazetarja Fatmira Nikolli ka ushtruar të drejtën e saj për informim si gazetare dhe pjesë e Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit (bashkëlidhur kallëzimit) dhe, sipas shkresës me Nr.F-21754/1 date 23.10.2019 përgjigja rezulton të jetë se: “Nuk kemi dijeni, s’kemi marë dokumentacionin”.

Në lidhje me këtë përgjigje, nga ana e gazetares është publikuar artikulli përkatës në Gazetën Shqiptare, artikull i cili pas disa orësh rezulton të jetë abyllur (shikoni dokumentin bashkëngjitur “Linku i klikuar nuk punon”).

Në përgjigjen e tij, Drejtori i Përgjithshëm Alban Dokushi, u shpreh se: “[J]u informojmë se Bashkia e Tiranës nuk është në dijeni të të gjithë procedurës që po bahet nga ky komision pasi sipas përcaktimeve [të VKM-së] Bashkia e Tiranës do të pajiset me dokumentacionin e plotë vetëm në fund të këtij procesi.” (dokumenti bashkëngjitur kallëzimit).

Në vazhden e të drejtës për informim, edhe Qendra “Res Publika” ka bërë kërkesën me Nr.216/19 datë 25.11.2019 në të cilën është kërkuar procedura e kërkuar nga Bashkia Tiranë për përcaktimin e procedurës së veçantë për marrësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt: “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”, shkresë e cila ka marë përgjigje dhe, për këtë qëllim, Qendra “Res Publika” ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Komisionerit për të drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Drejtave Personale.

Më datë 20.11.2019 sipas shkresës Nr.1838/1 Prot, Komisioneri për të drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Drejtave Personale, i ka kërkuar Bashkisë Tiranë përmes datës 26.11.2019 të trajtojë kërkesën dhe të rivlerësojë dhënien e informacionit të kërkuar (bashkëlidhur kallëzimit korespondensa përkatëse).

Nga faktet e paraqitura me sipër, na rezulton se nga ana e Bashkisë Tiranë nuk përmbushur detyrimet e përcaktuara me ligj për të drejtën e Informimit.



Gjatë gjithë kësaj periudhe, nga ana e Bashkisë Tiranë nuk është dhënë asnjë informacion me procedurat e tenderit dhe të fituesit për projektin e teatrit, gjë e cila na çon në në dyshime të arsyeshme se nga ana e Kryetarit të Bashkisë Tiranë ky informacion po mbahet i fshehtë pasi procedurat e ndjekura janë në shkelje të plotë të ligjit.

Sipas Kreut VII. në pikën 6 sanksionohet dhe mënyra e përzgjedhjes së konsulentit, i cili *do të paguhej me një fond limit deri në 50,000,000 lekë me TVSH*, ndërsa pika 7 sanksionon se *Ofertat e kualifikuara do të vlerësohen në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, sipas kriterëve të vlerësimit.*

Në referim të pikës 9. OFERTAT hapen nga komisioni në vendin, *datën dhe orën e përcaktuar në ftesën për ofertë. Komisioni shqyrton dokumentacionin e paraqitur nëse është në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi dhe të ftesës për ofertë.*

Po kështu, sipas kësaj pike, Komisioni, *brenda 3 (tri) ditëve pune, njofton dhe fton ofertuesit e kualifikuar për paraqitjen e ofertës teknike dhe financiare, ndërsa ofertuesit e pasuksesshëm për arsyet e skualifikimit.*

Në pikën 11. Përcaktohet se pas miratimit të raportit përmbledhës nga titullari i autoritetit kontraktor, *komisioni, brenda 5 (pesë) ditëve, fton operatorin fitues të negociojë kushtet e kontratës. Çmimi si kriter i vlerësimit është kusht i panegociueshëm. Palët duhet të përfundojnë negociimin brenda 7 (shtatë) ditëve.* Nëse dështojnë negociatat me operatorin fitues ose nëse ai tërhiqet, komisioni fton për negociim operatorin e radhës, nëse ka. Në rast se nuk mbetet asnjë ofertues në garë, autoriteti kontraktor do të rihapë garën.

Po kështu, sipas pikës 12. parashikohet se *Në rast se negociimi rezulton i pasuksesshëm, kostoja e ekspertizës mbulohet nga autoriteti kontraktor.*

Referuar deklaratave të Kryetarit të Bashkisë Tiranë në mbledhjen e Këshilli Bashkiak dhe në media dhe jo vetëm, kemi mësuar faktin se procedurat e konkursit kanë përfunduar dhe në vitin 2020 do fillojnë punimet për teatrin e ri.

Nga ana tjetër, nga bashkia Tiranë në projekt buxhetin e vitit 2020 është parashikuar fondi i shpërblimit për firmën negociatore.

Në këto kushte, në mënyrë legjitime neve kallëzuesve na lind pyetja se nëse dalë një FITUES *pse Bashkia Tiranë parashikon fondin për shpërblim ndërkohë që pika 12. e Kreut VII e parashikon ndryshe?*



Referuar pikës 1. të Kreut III. sanksionohet se në mbledhjen e tij të parë, komisioni harton thirrjen e hapur për palët private që janë të interesuara për të paraqitur një propozim për realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligjin Nr.37/2018 dhe në këtë vendim, mbi bazën e termave të referencës të hartuar nga Bashkia e Tiranës, thirrje e cila sipas pikës 2. depozitohet në protokollin e Bashkisë Tiranë dhe sipas pikës 3. Bashkia e Tiranës kryen të gjitha procedurat e nevojshme për publikimin në Buletinin e Njoftimeve Publike të thirrjes së hapur për shprehjen e interesit nga çdo palë private e interesuar të propozimeve dhe dokumentacionit të kërkuar për zhvillimin e zonës urbane të teatrit.

Po kështu, në këtë pikë përcaktohet se Thirrja publikohet dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë.

Sipas investigimeve të bëra nga ana jonë, nuk rezulton të jetë bërë publike në faqen e Bashkisë Tiranë asnjë nga procedurat e sipërcituara si dhe detyrimin ligjor për të shpallur fituesin dhe:

- Për të njoftuar me shkrim subjektin fitues;
- Për të njoftuar me shkrim subjektet e skualifikuara dhe shkakun e skualifikimit (me qëllim ankimin në APP dhe Gjykatën Administrative të subjekteve të skualifikuara).

Po kështu, nuk na rezulton që ky publikim të jetë bërë nga Agjensia e Prokurimit Publik.

Për këtë qëllim, në më datë 30.12.2019 u paraqitëm pranë Bashkisë Tiranë me qëllim marrjen e informacionit të munguar që nga data 18.10.2019 dhe, jo vetëm që nuk na u dha mundësia që të njiheshim me procedurat e ndjekura nga kjo bashki në konkursin për teatrin e ri por, na u mohua në mënyrë të dhunshme nga policia bashkiake hyrja në ambientete e një institucioni publik që është Bashkia e Tiranës.

Nisur procedurat që DUHET të ndiqte Autoriteti Kontraktor në zbatim të VKM-së Nr.352 datë 04.04.2019, Bashkia Tiranë nuk ka dhënë asnjë informacion me INTERES të gjërë publik si dhe nisur nga fakti se edhe sot në datën e përpilimit të këtij kallëzimi penal, ne nuk kemi marrë asnjë përgjigje ashtu si na garanton Kushtetuta, kërkojme që nga ana e Prokurorisë së Posaçme të hetohet dhe të jepet përgjigje në lidhje me pikat që ne pretendojmë se është konsumuar vepra penale e "Shpërdorimit të detyrës" si:

- Sa është numri i subjekteve të ofruara në konkurim;
- Kush janë subjektet e ofruara në konkurim në lidhje me firmën konsulente;



- Kusht është mënyra e përzgjedhjes së firmës konsulente fituese;
- A është paguar firma konsulente dhe nga kush?
- A i është ngarkuar shuma e shpenzimeve për firmën Konsulente subjektit FITUES?
- Nëse ka FITUES, (ashtu si e deklaroi në media dhe jo vetëm Kryetari i Bashkisë) pse duhet që shuma për firmën konsulente të planifikohet në Buxhetin e vitit 2020?
- Kush kanë qënë kriteret kualifikuese të subjektit FITUES?
- Kush kanë qënë kriteret vlerësuese të subjektit FITUES?
- Sa është vlera për projektin e ndërtimit sipas subjektit FITUES?
- A është lidhur kontrata me subjektin FITUES?
- Si është protokolluar procedura e fituesit?
- A është njoftuar Agjensia e Prokurimit Publik për firmën fituese?

Në këto kushte, referuar të gjithë parashtrimeve të mësipërme, ne konkludojmë se nga ana e Kryetarit të Bashkisë Tiranë me cilesinë e Autoritetit Kontraktor sipas VKM-së Nr.352 datë 04.04.2019 është konsumuar vepra penale e "Shpërdorimit të detyrës" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal i cili përcakton se:

*"Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet."*

Referuar gjithë pretendimeve tona sa më sipër,

**Kërkojmë:**

Nga ana e Prokurorisë së Posaçme të regjistrohet procedimi penal në ngarkim të shtetasit Erjon Veliaj me cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, për veprën penale "Shpërdorim i detyrës", të parashikuar nga neni 248, të Kodit Penal dhe dënimin e tij sipas ligjit.

Bashkëlidhur kallzimit i gjithë dokumentacioni që ne disponojmë.  
Jemi në pritje dhe me besim për zbardhjen e të vërtetës.

**KALLËZUES :**

1. **Ervin Goci**, i biri i Tefik dhe Violeta, i datëlindjes 27 Dhjetor 1982., lindur në Krujë dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti I21227032G me adresë: Rr.Naim Frashëri, P 61/7, AP 24;

Ervin Goci <sup>6</sup>